



RAPORT MONITORIMI

AUTOR
MARIO KOKONOZI



QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Contents

1. Hyrje	3
2. Çfare është Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurimit	4
2.1 Organizata e Kombeve të Bashkuara	4
2.2 Këshilli i Sigurimit	5
2.3 Kritikkat mbi OKB dhe Këshillin e Sigurimit	6
3. Shqipëria, dhe prioritetet e saj gjatë mandatit 2 vjeçar	7
4. Lufta në Ukrainë dhe hapat e ndërmarr nga Këshilli i Sigurimit	9
5. Pritshmëritë gjatë Mandatit të Shqipërisë	10
Bibliografia	12



1. Hyrje

Që prej 1 Janarit 2022 Shqipëria është pjesë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara me një mandat 2 vjeçar (Janar 2022-Dhjetor 2023). Ky është përfaqësimi më i lartë që ka patur ndonjëherë vendi ynë në organizatë ndërkombëtare. Një angazhim ky i një magnitude shumë të lartë dhe tejet delikate për atmosferën e tanishme politike por edhe një sfidë e madhe për vendin e vogël të Europës Jug-Lindore. Përfaqësimi në tryezën më të fuqishme në botë, atë të Këshillit të Sigurimit, ku merren vendime që ndryshojnë fatet për shumë njerëz, është mbi të gjitha një përgjegjësi e veçantë dhe nder për çdo shtet, qoftë me qindra miliona banorë, qoftë me një milion banor. Andaj, kjo nuk duhet të jetë një pengesë për vendin tonë për të lënë një gjurmë dhe pse jo një trashgimi në arenën ndërkombëtare. Sfidat, prioritetet dhe ndikimi i luftës në Ukrainë në ulësen e Shqipërisë në KS, janë disa nga pikat kryesore që zhvillohen në këtë raport monitorimi.

Fjalë kyçe: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Shqipëria, sfida, luftë, Ukrainë, zhvillim i qëndrueshëm, prioritete



2. Çfare është Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurimit

2.1 Organizata e Kombeve të Bashkuara

“Organizata e Kombeve të Bashkuara është një organizatë ndërkombëtare e krijuar në 1945 mbas Luftës së Dytë Botërore nga 51 vende të përkushtuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis kombeve dhe promovimin e përparimit social, standardeve më të mira të jetesës dhe të drejtave të njeriut”¹.

Këto janë rreshtat e parë që çdokush mund të lexojë me një klikim të thjeshtë në faqen online të OKB-së. Sot OKB ka 193 anëtarë me të drejtë vote. Të gjitha shtetet anëtare përfaqësohen me një ambasador të përhershëm pranë selisë qendrore në Neë York. OKB mund të ndërmarrë veprime për një numër të madh situatash dhe problemesh në çdo vend të botës, ku ka anëtarësi. 193 anëtarët e saj mund të shprehin pikëpamjet e tyre nëpërmjet organeve që përbëjnë organizatën, gjashtë të cilët janë Asambleja Gjenerale, Këshilli i Sigurimit, Këshilli Ekonomik dhe Social, Sekretariati, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës dhe Këshilli i Kujdestarisë² si dhe një numër i madh trupash dhe komitetesh të tjerë³.

Dokumenti më i rëndësishëm dhe ai themelues i OKB-së është Karta e Kombeve të Bashkuara, e firmosur në 26 Qershor 1945, në San Francisko SHBA, në përfundim të Konferencës së OKB-së mbi Organizatat Ndërkombëtare dhe erdhi në fuqi në 24 Tetor 1945. OKB mund të ndërmarr veprim mbi një numër të lartë çështjesh falë fuqisë që delegohet nga Karta. Në këtë mënyrë, Karta konsiderohet një traktat ndërkombëtar dhe një instrument i të drejtës ndërkombëtare dhe anëtarët e OKB-së janë të lidhur me të, duke iu bindur parimeve që shprehen në të⁴.

Puna e OKB-së prek çdo cep të botës dhe çdo aspekt të jetës sonë. Ajo që të gjithë shohin është puna e OKB-së në organet e mëdha të cilat marrin dhe më shumë vëmendje sidomos mediatike, por disa aspekte të punës prekin, ruajtjen dhe krijimin e paqes në botë, ndihmën humanitare si dhe, parandalimin e konflikteve. Nga ana tjetër, OKB merret në rang global me, barazinë gjinore, zhvillimin social, zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e refugjatëve, të drejtat e njeriut, qeverisjen, promovimin e demokracisë, etj. Të gjithë këto komponentë arrijnë të realizojnë objektivat që vendos OKB.

¹ <https://www.un.org/un70/en/content/history/index.html#:~:text=The%20United%20Nations%20is%20an,living%20standards%20and%20human%20rights>

² [https://www.un.org/en/model-united-nations/un-structure#:~:text=The%20United%20Nations%20\(UN\)%20has,The%20Hague%20in%20the%20Netherlands.](https://www.un.org/en/model-united-nations/un-structure#:~:text=The%20United%20Nations%20(UN)%20has,The%20Hague%20in%20the%20Netherlands.)

³ <https://www.un.org/en/about-us/main-bodies#:~:text=The%20main%20bodies%20of%20the,Organization%20was%20founded%20in%201945>

⁴ <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>



Më të fundit, janë ato të Agjendës 2030, e cila përbëhet nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat janë 17 dhe prekin çdo aspekt të jetës sonë. Kjo agjendë është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe prosperitetin⁵. Të gjitha vendet dhe palët e interesuara e implementojnë këtë agjendë, përfshirë dhe vendi ynë⁶. Agjenda së bashku me 17 objektivat të cilat përbëhen nga 169 tregues dhe indikatorë, është e përkushtuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis kombeve dhe promovimin e përparimit social, standardeve më të mira të jetesës dhe të drejtave të njeriut. Ato janë të integruara dhe të pandashme dhe balançojnë tre dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm: atë ekonomik, social dhe mjedisor. Qëllimet dhe objektivat do të stimulojnë veprimin gjatë 15 viteve të ardhshme në fusha me rëndësi kritike për njerëzimin dhe planetin⁷.

2.2 Këshilli i Sigurimit

Këshilli i Sigurimit është organi kryesor i menaxhimit të krizave dhe është i autorizuar të vendosë vendime detyruese për 193 shtetet anëtare të OKB-së për të ruajtur paqen. Trupi ka pesë anëtar të përhershëm që janë pjesë e tryezës që nga krijimi i OKB-së, të cilët janë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Kina dhe Rusia. Nga ana tjetër, Këshilli ka dhe dhjetë anëtarë jo të përhershëm të cilët zgjidhen me mandat dy vjeçar duke marrë dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve në Asamblenë e Përgjithshme. Presidenca e Këshillit lëviz me rotacion brenda 15 vendeve të Këshillit, çdo muaj, duke i dhënë mundësi secilit vend të vendosi agjendën e diskutimeve, duke i dhënë në këtë mënyrë çdo vendi mundësinë për të influencuar dhe për të vendosur rendin e çështjeve për tu diskutuar. Kriteri i vetëm për të qënë pjesë për çdo shtet është kontributi për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Që në vitin 1965, OKB zgjedh pesë anëtar nga vendet afrikane dhe aziatike, një nga Europa Lindore, dy nga Amerika Latine dhe dy nga Europa Perëndimore dhe vende të tjera⁸. Aktualisht anëtarët jo të përhershëm të Këshillit të Sigurisë janë, Shqipëria, Brazili, Gabon, Gana, India, Irlanda, Kenia, Meksika, Norvegjia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe⁹.

Pesë anëtarët e përhershëm dhe dhjetë të zgjedhurit takohen rregullisht për të vlerësuar kërcënimet ndaj sigurisë ndërkombëtare, duke përfshirë, luftrat, katastrofat natyrore, përhapjen (proliferimin) e armëve, dhe terrorizmin.

Pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit njohur ndryshe dhe si P5, kanë të drejtën e vetos në Këshill, duke penguar vendime apo rezoluta të

⁵ https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E

⁶ <http://www.instat.gov.al/al/sdgs/>

⁷ <https://sdgs.un.org/2030agenda>

⁸ https://www.un.org/en/ga/62/plenary/election_sc/bkg.shtml#:~:text=Under%20rule%2083%20of%20the,are%20listed%20in%20annex%20IV

⁹ <https://www.un.org/securitycouncil/content/current-members>



ndryshme, që bien ndesh me linjat e politikës që ata ndjekin dhe që shihen si të panegociushme. Duke u kthyer pas në histori, Federata Ruse është vendi që e ka përdorur më shumë të drejtën e vetos, sidomos në kohën e Bashkimit Sovietik, duke penguar mbi njëqindë rezoluta¹⁰. Hera e fundit kur është përdorur kjo e drejtë ishte mbi rezolutën që synonte të ndalonte luftën në Ukrainë, e shkruar në 25 Shkurt 2022 nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit¹¹.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në vend të dytë, dhe e kanë përdorur veton për qëllime nga më të ndryshmet por më së shumti lidhur me mbrojtjen e Izraelit në konfliktin e saj me Palestinën, ku numërohen të paktën 53 që nga viti 1972¹².

Republika popullore e Kinës e ka rritur numrin e përdorimit të vetos në vitet e fundit, ku për herë të parë e ka përdorur në vitin 1972 për të penguar aderimin e Bangladeshit në OKB¹³. Përdorimi i vetos nga Kina ka një natyrë pak më ndryshe sepse për interesa që nuk e prekin vet shtetin kinez, vota në Këshill të Sigurimit ka qënë abstenim, ashtu siç ndodhi dhe me rezolutën e fundit lidhur me tërheqjen e trupave Ruse nga Ukraina. Abstenimi i Kinës u pa si një fitore nga perëndimi duke i dhënë sinjal të qartë Federatës Ruse që ajo është e izoluar në arenën ndërkombëtare si dhe rriti vlerën e rezolutës e cila u votua pro nga 11 shtete, u abstenua nga India, Kina dhe Emiratet e Bashkuara Arabe dhe u refuzua nga Rusia¹⁴.

Këshilli suportohet nga organe që përfshijnë komitete mbi sanksionet, kundër-terrorizmin, armët kimike, etj. Brenda sekretariatit, Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse¹⁵ dhe Departamenti i Mbështetjes Operacionale¹⁶ menaxhojnë operacionet në terren.

2.3 Kritikat mbi OKB dhe Këshillin e Sigurimit

Nga ana strukturore Këshilli ka mbetur në përgjithësi i pandryshuar që nga themelimi i tij në vitin 1946, shpesh herë duke ngjallur debat nga anëtarët për reformim. Në vitet e fundit, interesat personale të shteteve kanë penguar aftësinë e Këshillit për tu përgjigjur ndaj konflikteve, krizave, si lufta në Siri, aneksimi i Krimesë, pandemia e Covid-19 apo edhe sëfundmi, lufta në Ukrainë.

Shumë kritika vijnë drejt Këshillit të Sigurimit mbi mungesën e transparencës së metodikave të punës, mos patjen e një përfaqësimi të plotë duke sjell kështu

¹⁰ <https://library.cqpress.com/cqresearcher/document.php?id=cqresrre1946091800>

¹¹ <https://www.npr.org/2022/02/25/1083252456/russia-vetoes-un-security-council-resolution-that-denounces-its-invasion-of-ukra>

¹² <https://www.aljazeera.com/news/2021/5/19/a-history-of-the-us-blocking-un-resolutions-against-israel>

¹³ <https://icsin.org/blogs/2021/05/30/1767/>

¹⁴ <https://news.sky.com/story/ukraine-invasion-china-abstains-from-voting-on-un-security-council-resolution-condemning-russia-12551720>

¹⁵ <https://peacekeeping.un.org/en/department-of-peace-operations>

¹⁶ <https://operationalsupport.un.org/en>



zë më të pakët për anëtarët dhe ndërkohë duke sjell një shije jo demokratike për një numër të konsiderueshëm vendesh. Nga një përfaqësi me 193 vende anëtar, vetëm 10 kanë të drejtën të jenë pjesë gjatë punimeve në Këshillin e Sigurimit. Nga ana tjetër, 5 anëtar të përhershëm të cilët janë të pazëvendësueshëm që prej krijimit të Këshillit të Sigurimit sjellin një frymë jo të mirë tek 188 anëtarët e tjerë.

Një tjetër aspekt që kritikët i mëshojnë, lidhet me të drejtën e vetos që kanë P5. Shpesh herë veto është përdorur për interesa personal dhe jo e bazuar tek parimet e Kartës së OKB-së¹⁷.

3. Shqipëria, dhe prioritetet e saj gjatë mandatit 2 vjeçar

Mbas 65 vjetësh si anëtare, Shqipëria u zgjodh si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit me një mandat 2 vjeçar gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithsme të OKB-së, me datë, 11 qershor 2021. Vendi ynë arriti të mbledh 175 vota nga gjithë anëtarësia e OKB-së¹⁸. Për të arritur këtë qëllim, Shqipëria ka kryer një fushatë të suksesshme shumëvjevare të kryer nga të gjitha strukturat e Shërbimit të Jashtëm, si dhe ishte një kandidaturë konsensuale, që do të thotë që ishim kandidatura e vetme nga rajoni i Evropës Lindore, dhe zgjedhja në Këshill ishte e sigurt, duke zëvendësuar kështu Estoninë si anëtare e Evropës Lindore në KS¹⁹.

Paraprakisht, vendi ynë ka ndërmarr disa hapa në rrugëtimin e saj në OKB, ku theksohet kontributi në role të ndryshme të mbajtura ndër vite si për shembull, të qenit anëtare në Këshillin Ekonomik dhe Social, UN Habitat, UNICEF, Këshillin e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, si dhe të qenit zëvendës president i sesionit të 75-të të Asamblesë Gjenerale²⁰.

Prioritetet e vendit tonë gjatë mandatit të saj, gjenden në një dokument²¹ të përgatitur nga ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i cili përmban pikat kryesore të fushatës së lobimit që ka kryer vendi ynë, në kërkim të votës nga shtetet e tjera. Aty detajohet edhe aspirata e Shqipërisë që shpreh gatishmërinë për tu angazhuar në organizatën më të madhe në botë si një partner i besueshëm, që angazhohet në mënyrë aktive ndaj kërcënimeve ndaj paqes dhe sigurisë globale.

¹⁷ <https://www.euclid.int/papers/Collen%20Kelapile%20-%20UNSC%20Effectiveness.pdf>

¹⁸ <https://www.reuters.com/world/albania-brazil-gabon-ghana-uae-elected-un-security-council-2021-06-11/>

¹⁹ <https://www.punetejashme.gov.al/shqiperia-ne-ks-2022-2023/>

²⁰ <http://ambasadat.gov.al/united-nations/albania-an-active-contributor-to-the-un/>

²¹ <https://www.punetejashme.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Security-Council-UN.pdf>



Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS) është një agjendë me politika të cilat promovojnë gratë, që ato të jenë aktore kritike në të gjitha përpjekjet për të arritur paqen dhe sigurinë e qëndrueshme. Agjenda e ĒPS ka ardhur nga Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila u miratua unanimitisht më 31 tetor 2000²². Një prioritet i mandatit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit është pikërisht kjo agjendë, të cilën vendi ynë do ta mbrojë në të gjithë mediumet e punës në KS. Sipas dokumentit promovues, vendosja e grave dhe vajzave në qendër të paqes dhe sigurisë, është një investim i mirë për paqen më afatgjatë dhe më të qëndrueshme²³.

Të drejtat e njeriut dhe ligji ndërkombëtar dhe promovimi i tyre është një tjetër pikë e rëndësishme e mandatit tonë. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë individët dhe grupet është një parakusht kryesor për paqen afatgjatë, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, ne do të punojmë për të avancuar standardet e të drejtave të njeriut në mbarë botën²⁴. Thënë kjo, sidomos tani që Rusia ka shpallur luftë kundrejt perëndimit me anë të sulmit barbar ndaj Ukrainës, që ka lënë me mijëra të vrarë dhe ka zhvendosur miliona njerëz nga shtëpitë e tyre.

Pikë të tjera të rëndësishme të mandatit shqiptar në Këshillin e Sigurimit janë **lufta ndaj ekstremizmit të shunshëm, zgjidhjet gjithëpërfshirëse me anë të bashkëpunimit** si dhe **klima dhe siguria**. Vendi ynë do të jetë një mbështetës i forcimit të politikave që adresojnë ekstremizmin e dhunshëm si dhe ndryshimet klimaterike. Aktorët lokal dhe rajonal luajnë një rol të madh në inicimin e dialogut ndër sektorial i cili krijon kushtet për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të parandaluar konfliktet dhe në ndërtimin e paqes²⁵.

Prioritetet janë aty për të treguar një qasje kuptimplotë ndaj angazhimit në Këshillin e Sigurimit. Ato janë busulla jonë orientuese për të udhëhequr mandatin tonë si dhe për ti bërë ball sfidave që hasen nga tryeza e KS. Vullneti i gjithë shtetit shqiptar dhe përfaqësisë diplomatike shprehet nëpërmjet rolit që ne tashmë kemi marr dhe nëpërmjet tij ne i tregojmë vendeve të tjera të botës, parimet, vlerat dhe qasjen tonë ndaj problemeve dhe rugëzgjdhjet që ne mund të ofrojmë në ruatjen e paqes dhe sigurisë ne botë.

²² <https://www.usip.org/programs/advancing-women-peace-and-security>

²³ http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/woman-peace-and-security/

²⁴ http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/human-rights-and-international-law/

²⁵ http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/inclusive-solutions-through-partnerships/



4. Lufta në Ukrainë dhe hapat e ndërmarr nga Këshilli i Sigurimit

Lufta në Ukrainë e nisur më, 24 Shkurt 2022 nga Federata Ruse kundrejt Ukrainës është e pa justifikueshme dhe kërcënim për paqen dhe sigurinë në botë. Luftimet ende vazhdojnë dhe ende nuk duket dritë në fund të tynelit për të arritur paqen për një vend që nuk e kërkoi këtë luftë. Ditët kalojnë dhe numri i qytetarëve të cilët e lënë vendin e tyre ka kaluar 10 milionë. Humbje jete dhe dëme materiale të panumërta ndodhin çdo ditë në çdo qytet të Ukrainës. Kjo luftë e paprecedentë e nisur nga Rusia pa asnjë provokim është minim i paqes dhe sigurisë në Europë dhe në botë.

Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy foli përpara Këshillit të Sigurimit në datën 5 Prill, ku fol për krimet e luftës që Rusia po ndërmerr në Ukrainë. Gjatë një fjalimi të mbushur përsëri plot emocion ai u shpreh që ajo çka po ndodh sot në Ukrainë krahasohet vetëm me Luftën e Dytë Botërore²⁶ dhe se një gjykatë speciale duhet të ngrihet për të ndëshkuar krimet e luftës që po ndodhin në Ukrainë²⁷.

Këshilli i Sigurimit pati një reagim imediat që në momentin që Rusia po kërcënonte me forcë të madhe integritetin e shtetit sovran të Ukrainës në dy tre ditët përpara sulmit. Aty, të gjitha shtetet dhe me në krye Sekretarin e Përgjithshëm Antonio Guterres folën për avancimin e forcave ruse si dhe bënë thirrje për dialog dhe paqe²⁸.

Trupat ruse u futën në Ukrainë dhe lufta tashmë kishte filluar. Këshilli i Sigurimit tentoi të kalonte një rezolutë që ndërpriste luftën në Ukrainë dhe kërkonte tërheqjen e trupave ruse nga territori i Ukrainës, një rezolutë e cila u shkrua nga Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyra e rezolutave që dalin nga Këshilli i Sigurimit kanë natyrë ligjore dhe detyruese për çdo shtet anëtar. Federata Ruse përdori të drejtën e vetos dhe kjo rezolutë nuk kaloi²⁹.

Disa ditë më vonë Asambleja Gjenerale kaloi një rezolutë që i kërkonte Rusisë tërheqjen e trupave nga territori i Ukrainës, një rezolutë që u përshendet nga shumica e shteteve të botës. Kundra kësaj rezolute kundër ishin vetem Federata Ruse, Eritrea, Siria, dhe Korea e Veriut, 35 shtete të tjera abstenuan nga votimi³⁰. Rezolutat e Asamblesë Gjenerale kanë natyrë këshilluese dhe rekomanduese për çdo shtet.

²⁶ <https://www.bbc.com/news/world-europe-61002914>

²⁷ <https://www.aljazeera.com/news/2022/4/5/zelenskyy-urges-un-to-ensure-russia-adheres-to-rules-of-intl-law>

²⁸ https://www.youtube.com/watch?v=-9qKBdEI_co

²⁹ <https://www.un.org/press/en/2022/sc14808.doc.htm>

³⁰ <https://www.aljazeera.com/news/2022/3/3/un-general-assembly-demands-russia-withdraw-troops-from-ukraine#:~:text=Most%20of%20the%20world's%20nations,Moscow's%20invasion%20of%20its%20neighbour.>



Nga ana tjetër, OKB ka kryer një punë të shumë të mirë lidhur me ndihmën ndaj refugjatëve ukrainas të cilat janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Asambleja Gjenerale kaloi një rezolutë të krijuar nga Ukraina, për të çuar ndihmë humanitare në Ukrainë³¹. Në datën 1 Mars, u alokuan 1.7 miliard dollar për ndihmë humanitare nga OKB³².

5. Pritshmëritë gjatë Mandatit të Shqipërisë

Mandati i Shqipërisë në KS është një mundësi e artë për të bërë shumë për vendin tonë. Kjo është një mundësi që vjen një herë në shumë dekada dhe kjo tregon që vlen shumë si mundësi. Ajo që duhet të kuptojmë është që mbas këtij angazhimi madhor duhet të mbetet diçka për vendin tonë. Ne duhet të ndihemi krenar për gjithë aktivitetin e kryer edhe vite mbasi ai ka mbaurar. Thënë kjo, duhen disa "indikatore të matjes së performancës". Këto indikatorë do të na ndihmojnë për të kuptuar angazhimin tonë dhe për të lënë diçka për gjeneratat që do të vijnë.

- KS dhe vizibiliteti që ofron ai organ është një platformë e jashtëzakonshme për të promovuar vlerat dhe parimet e vendit tonë. Qeveria jonë së bashku me përfaqësuesit e saj në Neë York, duhet ta përdorin platformën për të dhënë më të mirën e mundshme që çdo shtet të kuptojë që ne promovojmë paqen, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, etj. Deri më tani, kjo rezultoi e vertetë. Janë për tu përgëzuar fjalimet e shumta të ambasadorit tonë Ferit Hoxha, i cili me një gjuhë të drejtëpërdrejtë³³ ka folur hapur mbi krimet e Rusisë në Ukrainë, krizën humanitare të cilën po kalon Ukraina dhe më tej. Delegacioni i Shqipërisë ka qënë i gatshëm për tu shprehur në çdo moment, duke bërë jehonë në të gjithë hapësirën diplomatike si dhe në rrjete sociale³⁴.
- Shqipëria duhet të përdor këtë momentum për të promovuar njohjen e Kosovës. Shqipëria ndodhet në konditat perfekte për të lobuar për njohjen e Kosovës nga ato shtete që nuk e njohin.
- Shqipëria është zëri i Ballkanit për të gjitha vendet e rajonit. Vendi ynë këto dy vite ka fatin për të qënë i vetmi vend i Evropës Lindore dhe asaj Juglindore gjithashtu. Misioni jonë në Neë York, duhet ta përdori më së miri këtë mundësi të artë për të ngritur çështjet më emergjente në rajon duke vendosur theksin tek dialogu dhe gjithëpërfshirja.

³¹ <https://news.un.org/en/story/2022/03/1114632>

³²

<https://news.un.org/en/focus/ukraine#:~:text=On%201%20March%202022%2C%20the.and%20refugees%20in%20neighbouring%20countries.>

³³ <https://punetejashme.gov.al/en/remarks-by-ferit-hoxha-at-the-general-assembly-on-draft-resolution-on-armed-aggression-by-the-russian-federation-against-ukraine/>

³⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=aJYmBBOfhIA>



- Vendi ynë duhet të promovojë punën e deritanishme dhe duhet të llojë fort për të hapur negociatat me Bashkimin Europian. Përsëri edhe për këtë çështje, vendi ynë ndodhet në vendin perfekt për të rritur ndikimin e tij dhe për të hapur negociatat.
- Kjo karrige në KS duhet të përdoret për të sjellë investitorë dhe investime strategjike në Shqipëri. Vendi ynë mund të llojë për fonde, kontrata si dhe investime të llojeve të ndryshme në vendin tonë. Ashtu si kundër, mund të rrisë ndikimin e OKB-së dhe agjensive të saj në Shqipëri. Vendi ynë gjithashtu mund të llojë për rritje të fondeve që kanë këto agjensi në vendin tonë. Shkrimet e shtypit por edhe studimet tregojnë që prezenca në Këshillin e Sigurimit lehtëson marrjen e huave nga Banka Botërore³⁵ si dhe për këto vende ka një investim të shtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe OKB³⁶.



³⁵ <https://foreignpolicy.com/2017/10/05/un-security-council-members-are-more-likely-to-receive-world-bank-loans-united-states-mexico/>

³⁶ <https://www.hbs.edu/ris/Publication%20Files/06-029.pdf>

Bibliografia

Allen-Ebrahimian, B. (2017) "U.N. Security Council Members Are More Likely to Receive World Bank Loans" <https://foreignpolicy.com/2017/10/05/un-security-council-members-are-more-likely-to-receive-world-bank-loans-united-states-mexico/> Foreign Policy (Aksesuar 15.04.2022)

Al Jazeera (2022) "Zelenskyy urges UN to 'act immediately' to stop Russian attacks" <https://www.aljazeera.com/news/2022/4/5/zelenskyy-urges-un-to-ensure-russia-adheres-to-rules-of-intl-law> (Aksesuar 12.04.2022)

Al Jazeera (2022) "UN General Assembly demands Russia withdraw troops from Ukraine" <https://www.aljazeera.com/news/2022/3/3/un-general-assembly-demands-russia-withdraw-troops-from-ukraine#:~:text=Most%20of%20the%20world's%20nations,Moscow's%20invasion%20of%20its%20neighbour.> (Aksesuar 13.04.2022)

BBC (2022) "Ukraine war: Zelensky tells UN of horrors of Russian invasion" <https://www.bbc.com/news/world-europe-61002914> (Aksesuar 12.04.2022)

CQ Researcher "Veto Power in the United Nations" <https://library.cqpress.com/cqresearcher/document.php?id=cqresrre1946091800> (Aksesuar 29.03.2022)

Department of Operational Support of the United Nations <https://operationalsupport.un.org/en> (Aksesuar 02.04.2022)

General Assembly of the United Nations (2015) "Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development" Resolution adopted by the General Assembly on 25 September 2015 https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E (Aksesuar 26.03.2022)

General Assembly of the United Nations "Election of five non-permanent members of the Security Council" https://www.un.org/en/ga/62/plenary/election_sc/bkg.shtml#:~:text=Under%20rule%2083%20of%20the,are%20listed%20in%20annex%20IV (Aksesuar 27.03.2022)



Gillespie, T. (2022) "Ukraine invasion: China abstains from voting on UN Security Council resolution condemning Russia" Sky News
<https://news.sky.com/story/ukraine-invasion-china-abstains-from-voting-on-un-security-council-resolution-condemning-russia-12551720>

Instituti i Statistikave "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm"
<http://www.instat.gov.al/al/sdgs/> Instat (Aksesuar 26. 03. 2022)

Kelapile, C. "The Effectiveness of the United Nations Security Council"
<https://www.euclid.int/papers/Collen%20Kelapile%20-%20UNSC%20Effectiveness.pdf>

Kuziemko, I, Werker, E. (2006) "How Much Is a Seat on the Security Council Worth? Foreign Aid and Bribery at the United Nations"
<https://www.hbs.edu/ris/Publication%20Files/06-029.pdf> Harvard Business School (Aksesuar 15.04.2022)

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (2021) "Shqipëria në KS 2022-2023"
<https://www.punetegashtme.gov.al/shqiperia-ne-ks-2022-2023/> (Aksesuar 04.04.2022)

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (2022) "Remarks by Ferit Hoxha at the General Assembly on Draft-Resolution on armed Aggression by the Russian Federation against Ukraine"
<https://punetegashtme.gov.al/en/remarks-by-ferit-hoxha-at-the-general-assembly-on-draft-resolution-on-armed-aggression-by-the-russian-federation-against-ukraine/> (Aksesuar 15.04.2022)

Newton, C. (2021) "A history of the US blocking UN resolutions against Israel" Al Jazeera
<https://www.aljazeera.com/news/2021/5/19/a-history-of-the-us-blocking-un-resolutions-against-israel>

Permanent Mission of Albania to the UN in New York "Albania an active contributor to the UN"
<http://ambasadat.gov.al/united-nations/albania-an-active-contributor-to-the-un/> (Aksesuar 28.03.2022)

Permanent Mission of Albania to the UN in New York "Meeting Global Challenges Through Partnerships Albania for UN Security Council 2022-2023"
<https://www.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Security-Council-UN.pdf> (Aksesuar 28.03.2022)



Permanent Mission of Albania to the UN in New York "Human Rights and International Law" http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/human-rights-and-international-law/ (Aksesuar 12.04.2022)

Permanent Mission of Albania to the UN in New York "Inclusive Solutions Through Partnerships" http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/inclusive-solutions-through-partnerships/ (Aksesuar 12.04.2022)

Permanent Mission of Albania to the UN in New York "Women, Peace, and Security" http://ambasadat.gov.al/united-nations/ova_dep/woman-peace-and-security/ (Aksesuar 12.04.2022)

Reuters (2021) "Albania, Brazil, Gabon, Ghana, UAE elected to U.N. Security Council" <https://www.reuters.com/world/albania-brazil-gabon-ghana-uae-elected-un-security-council-2021-06-11/> (03.04.2022)

Romo, V. (2022) "Russia vetoes UN Security Council resolution that denounces its invasion of Ukraine" National Public Radio <https://www.npr.org/2022/02/25/1083252456/russia-vetoes-un-security-council-resolution-that-denounces-its-invasion-of-ukra>

sdg.un.org "Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development" United Nations Department of Social and Economic Affairs <https://sdgs.un.org/2030agenda> (Aksesuar 26.03.2022)

Study.com "Multilateralism: Definition & International Relations" <https://study.com/academy/lesson/multilateralism-definition-international-relations.html#:~:text=Multilateralism%20is%20when%20at%20least,or%20interests%20of%20other%20states> (Aksesuar 12.04.2022)

Thareima, Ch. (2021) "China's Changing Role in The United Nations Security Council, 2007-2017" International Continenace Society <https://icsin.org/blogs/2021/05/30/1767/> (Aksesuar 02.04.2022)

United Nations Peacekeeping "Department of Peace Operations" <https://peacekeeping.un.org/en/department-of-peace-operations> (Aksesuar 02.04.2022)

United Nations Security Council "Permanent and non-permanent members" <https://www.un.org/securitycouncil/content/current-members> (Aksesuar 25.03.2022)



United Nations (2015) "History of the UN"
<https://www.un.org/un70/en/content/history/index.html#:~:text=The%20United%20Nations%20is%20an,living%20standards%20and%20human%20rights>
(Aksesuar 25.03.2022)

United Nations "Model United Nations, UN Structure"
[https://www.un.org/en/model-united-nations/un-structure#:~:text=The%20United%20Nations%20\(UN\)%20has,The%20Hague%20in%20the%20Netherlands.](https://www.un.org/en/model-united-nations/un-structure#:~:text=The%20United%20Nations%20(UN)%20has,The%20Hague%20in%20the%20Netherlands.) (Aksesuar 25.03.2022)

United Nations "Main Bodies" <https://www.un.org/en/about-us/main-bodies#:~:text=The%20main%20bodies%20of%20the,Organization%20was%20founded%20in%201945> (Aksesuar 25.03. 2022)

United Nations "United Nations Charter" <https://www.un.org/en/about-us/un-charter> (Aksesuar 25.03.2022)

United Nations "Security Council Fails to Adopt Draft Resolution on Ending Ukraine Crisis, as Russian Federation Wields Veto"
<https://www.un.org/press/en/2022/sc14808.doc.htm> (Aksesuar 13.04.2022)

United States Institute of Peace "Advancing Women, Peace and Security U.S. Civil Society Working Group on Women, Peace & Security (U.S. CSWG)"
<https://www.usip.org/programs/advancing-women-peace-and-security>

United Nations (2022) "Ukraine: General Assembly passes resolution demanding aid access, by large majority"
<https://news.un.org/en/story/2022/03/1114632> (Aksesuar 13.04.2022)

United Nations (2022) "UN News, Ukraine"
<https://news.un.org/en/focus/ukraine#:~:text=On%201%20March%202022%2C%20the,and%20refugees%20in%20neighbouring%20countries.> (Aksesuar 13.04.2022)

Youtube (2022) "Watch Live: UN Security Council holds emergency meeting as Russian forces threaten to invade Ukraine"
https://www.youtube.com/watch?v=-9qKBdEl_co (Aksesuar 13.04.2022)

Youtube (2022) "United Nations Security Council holds a meeting on maintenance of peace in Ukraine — 4/11/22"
<https://www.youtube.com/watch?v=aJYmBBOfhIA> (Aksesuar 15.04.2022)





#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al